

VENDIM
Nr. 22, datë 9.1.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 138, DATË 12.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR RREGULLAT E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË SHKOLLËS SHQIPTARE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE, TRAJNIMIN E NËPUNËSVE CIVILË, SI DHE TË ÇDO INDIVIDIT TJETËR JASHTË SHËRBIMIT CIVIL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 11, dhe 9, pika 5, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 138, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun III bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 9/2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9/2. Fondet për trajnimin e nëpunësve, sipas pikës 9/1, të këtij kreu, që janë të punësuar në institucione buxhetore të administratës publike, përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit të akorduara në buxhetin vjetor të ASPA-s për këtë qëllim. Për të planifikuar fondet e nevojshme, ASPA bashkëpunon me institucionet që kanë nevojë për këto trajnime.”.

b) Pas pikës 9/2 shtohet pika 9/3, me këtë përmbajtje:

“9/3. Fondet për trajnimin e nëpunësve, sipas pikës 9/1 të këtij kreu, që janë të punësuar në institucionet/organizatat publike, që funksionojnë me vetëfinancim, shoqëritë aksionare publike dhe institucionet publike të arsimit të lartë përballohen nga fondet e vetë institucionit, ku janë të punësuar nëpunësit. Këto institucione paguajnë pranë ASPA-s 3 000 (tre mijë)–7 000 (shtatë mijë) lekë për kurs trajnimi për çdo nëpunës, në varësi të kohëzgjatjes së kursit.”.

2. Në kreun IV bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas shkronjës “d”, të pikës 1, shtohet shkronja “dh”, me këtë përmbajtje:

“dh) për programe trajnimi që lidhen me sigurinë e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit.”.

b) Në pikën 2, fjalët “Për trajnimet e parashikuara në pikën 1, të kreut IV, të këtij vendimi ...”, zëvendësohen me “Për trajnimet e parashikuara në shkronjat “a” deri në “d”, të pikës 1, të këtij kreu ...”.

3. Në kreun VI bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjën “b”, të pikës 2, fjalët “... dhe 6–10 vite...” zëvendësohen me “... dhe mbi 5 deri në 10 vjet ...”;

b) Në shkronjën “c”, të pikës 2, fjalët “... dhe mbi 11 vite...” zëvendësohen me “... dhe mbi 10 vjet ...”;

c) Shkronjat “b” dhe “b/1”, të pikës 4, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“b) për kontratat e parashikuara në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij kreu, masa e pagesës për hartimin e kurrikulave apo të materialeve të trajnimit, të nevojshme për zhvillimin e 6 orëve 60-minutëshe trajnimi, të jetë:

i. 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë për trajnerët që plotësojnë kriteret e parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 3 të këtij kreu;

ii. 36 000 (tridhjetë e gjashtë mijë) lekë për trajnerët që plotësojnë kriteret e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 3, të këtij kreu;

b/1) për kontratat e parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij kreu, masa e pagesës për vlerësimin e cilësisë së kurrikulave apo materialeve të trajnimit të nevojshme për zhvillimin e 6 orëve 60-minutëshe trajnimi, të jetë 20 000 (njëzet mijë) lekë;”.

4. Lidhja nr. 1 bashkëlidhur vendimit zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2025.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MASAT E PAGESAVE PËR TRAJNERËT

Kategoria e trajnerëve	Masa e pagesës
I ulët	2 000 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi
I mesëm	2 500 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi
I lartë	3 500 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi
Trajnerë të kategorisë së veçantë	4 000 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi